

URDHËR
Nr. 220, datë 4.8.2021

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 1 e nenit 12 dhe pikës “b”, të nenit 13, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të germës “c”, pika 2 e nenit 7, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, në mungesë të kryetarit të Kolegjit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e pjesshëm të kompetencave të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, gjyqtarit më të vjetër në moshë, z. Ardian Hajdari, për periudhën 5 gusht 2021 deri më 16 gusht 2021.

2. Gjyqtari z. Ardian Hajdari për periudhën sipërcituar do të nënshkruajë në emër të kryetarit në mungesë të tij;

- Shkresat që dalin nga institucioni drejtuar Komisionerit Publik, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, si dhe denoncuesve, lidhur me denoncimet e paraqitura prej tyre pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të cilat janë brenda afatit të ankimit.

3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet gjyqtari më i vjetër në moshë, z. Ardian Hajdari.

4. Gjyqtari z. Ardian Hajdari nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Albana Shtylla